



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/2020

Datë: 29.12.2020

Procesverbal

i mbledhjes se X (dhjetë) të rregullt për vitin 2020 e Komitetit për Politikë dhe Financa
REND I DITES

1. Shqyrtimi i kërkesës nr.01/1154 datë: 11.11.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, për vazhdimin e shërbimeve të varrimit për banorët e Komunës së Malishevës për vitin 2021.
2. Raporti i Komisionit Komunal të Aksionareve për periudhën Janar – Dhjetor 2020.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i planeve të Punës të Komiteteve dhe Komisioneve për vitin 2021
 - Komitetit për Komunitete
 - Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
 - Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dhe Persona me Aftësi të Kufizuara
 - Komiteti për Familje të dëshmorëve, Invalid, veteranë të Luftës së UÇK-së, si dhe të Martirëve të Luftës
 - Komiteti për Diasporë
 - Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër, Turizëm, Mbrojtje të Mjedisit dhe monitorim të projekteve publike
 - Komiteti për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
 - Komiteti për Barazi Gjinore
 - Komisioni Komunal i Aksionarëve
4. Shqyrtimi i kërkesave.
5. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 11.12.2020 duke filluar në ora 13:30, morën pjesë 5 anëtarë të KPF-së, zyra për informim.

Rahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve, sot në mbledhje mungojnë dy anëtarë të KPF-së, por kuorum kemi. Disa materiale i keni sot si dhe disa kërkesa që kanë ardhur me vonesë unë ju kam sjellë por ju si të doni ose i trajtojmë ose i lemë për mbledhjen e radhës.

Alban Krasniqi: Propozoj të futet në rend dite një raport lidhur me ndërtimin e Shkollës në fshatin Gurbardh, tejkalimi i projekteve, bartja e mjeteve etj.

Rahim Morina: Ne e kemi si pikë raportin e Drejtorisë për Urbanizëm.

Alban Krasniqi: Të kemi informacion shtesë pra me pas diskutim kualitativ, sepse ka edhe projekte tjera që dyshohen për konflikt interesi e jo veç raport të thjeshtë. Tani kryesues nga asamblisti i LDK-së është ngrite një problem edhe në shkollën e Astrazupit lidhur me vendosjen e nxemjes.

Hashim Vrenezi: Kemi propozim të futet në rend dite edhe Rregullorja për taksa dhe ngarkesa pasi që disa biznese janë ngarkuar me tatim kur dihet se ne me Rregulloren i kemi liruar, pra janë disa institucione transferi.

Rahim Morina: Tani Hashim nuk mund të kthehemi mbrapa në rregullore pasi që na humbë kohë me procedura por mbledhjen që vjen e kemi në rend dite Rregulloren për vitin 2021 dhe aty diskutojmë dhe japim propozimet tona. Sot mund ta fusim në rend dite, zbatimin e Rregullores për taksa dhe ngarkesa.

Raimonda Krasniqi: Tash na erdhi material dhe disa kërkesa që ne për këtë mbledhje e kemi të pamundur ta lexojmë, propozoj që veç ndonjë kërkesë urgjente ta trajtojmë, sepse kjo mënyrë kështu është jo serioze.

Valon Krasniqi: Kërkesat që na vijnë në mbledhje ne s'kemi kohë t'i diskutojmë.

Alban Krasniqi: Standardet të mos te jenë të dyfishta, ne mund te ju japim dritën jeshile për kuvend, të shërbimet e varrimit ne duhet t'i dimë sa shpenzime janë krijuar brenda një muaji. Për disa kërkesa nuk kemi material.

Hashim Vrenezi: Unë kërkoj ta shtyjmë këtë mbledhje pasi që një pjesë të materialit e pranuar sot.

Rrahim Morina: Kush pra që kjo mbledhje të shtyhet për datën: 14.12.2020? Unanimisht ishin për.

Vazhdimi i mbledhjes filloj me datë: 14.12.2020, të pranishëm në mbledhje ishin 7 anëtarë të KPF, Zip, zyrtari nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport Mejdi Krasniqi.

Rrahim Morina: Sot kemi një pjesë të materialit që tani po besoj që e keni lexuar me datë: 11 keni kërkuar të futen dy pika të reja në rend dite.

Hashim Vrenezi: Janë dy kërkesa me data të ndryshme njëra, njëra ka ardhur me vonë dhe e keni sjelle me material njëra është protokolluar me herët e keni sjellë sot.

Rrahim Morina: Unë disa herë kam kërkuar që të jetë një zyrtar në protokoll që shkresat t'i përcjellë nëpër drejtori kur në i rekomandojmë e jo ne vet duhet të interesohemi te ju dërgojmë.

Alban Krasniqi: Ajo çka po thu kryesues qëndron se është praktikë kur pala dërgon një kërkesë brenda Institucionit ai e kryen obligimin edhe pse protokollin prej zyrtarëve është rrush se i kanë marrë militantet e partisë që kur ju kanë kërkuar votën ju kanë premtuar edhe vende të punës ose veç me një fotografi kur e kanë bërë me ta. Pra faji është te administrata e ne përballemi këtu po pësojnë qytetarët, por unë jam të trajtohen kërkesat e qytetarëve pa dallim.

Rrahim Morina: Kush jeni me këtë rend të ditës për këtë mbledhje me plotësime? Unanimisht ishin për.

Halil Morina: Sot vërtetë e kemi problem t'i trajtojmë gjitha këto pika.

1. Shqyrtimi i kërkesës nr.01/1154 datë: 11.11.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, për vazhdimin e shërbimeve të varrimit për banorët e Komunës së Malishevës për vitin 2021.

Rrahim Morina: Biku në një takim që kemi pas kanë kërkuar që shpenzimet e varrimit të mbulohen për secilin rast, por ata thanë që edhe pandemia ka ndikuar dhe kam krijuar shpenzime sidomos të dezinfektimi dhe që sipas tyre kanë krijuar shpenzime.

Alban Krasniqi: Raporti qysh kemi kërkuar ska ardhur pra është raport i varfër krahas shumë që paguhet, s'është numri i rasteve e as i shërbimeve. Një justifikim pse kemi kërkuar është tash edhe drejtoria njëjtë e ka sjellë sikur Biku, kemi kërkuar edhe listat, pra shihet se transparenca ka rënë tash kërkesa për meju mbulu shpenzimet është rritur dokumentet mungojnë por në kërkojmë që raporti të jetë i plotë për secilin rast çka është mbuluar për dy vite, niveli i shërbimeve pra me heq dilemën se diçka po fshihet. Neve na intereson me ditë kaq shpenzime janë bërë, kaq kanë mbetur pra t'i ndajmë shpenzimet e varrimit me shpenzimet tjera që po kërkojnë ata me i mbuluar. Jo në emër të arvikolit që qytetarët se marrin ndoshta hiq por e nënshkruajnë, për familjet e te porsalindurve me ba 50% zbritje në shpenzime me pak.

Rrahim Morina: Është mirë ta bëjmë një takim në Kpf me përfaqësuesit e Bik-ut, ata ta bëjnë një specifikacion ata tani me thanë që i kanë edhe dy punëtorë.

Halil Morina: Të procedohet për kuvend për këto vite deri tani si marrëveshje ka qenë e suksesshme dhe ka qenë një punë e mirë në shërbim të qytetarëve. I vetmi dallim me rast është te çështja e arkivolit se shërbimet tjera janë të njëjta.

Alban Krasniqi: Mos thuaj ashtu e pastaj mu shpërnda si dezinformatë.

Hashim Vrenezi: Si marrëveshje duhet përkrahë sepse ka funksionuar mirë, mos të paragjykojmë se ata e keqpërdorin pavarësisht se mundet me pas vërejtje. Duhet kërkuar llogari dhe ata duhet me na dhënë sqarime neve.

Valon Krasniqi: Edhe unë jam që me Bik-un të bëjmë një takim.

Rrahim Morina: Takimin pra po e organizojmë ditën e Mërkurë në ora 13:30.

2. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komiteti për Barazi Gjinore për vitin 2021

3. Shqyrtimi i darft Planit të Komisionit Komunal të Aksionareve për vitin 2021.

Rrahim Morina: A jeni që keto dy kërkesa d'i rekomandojmë për Kuvend? Unanimisht ishin për.

4. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/503 datë:07.12.2020 të parashtruar nga N.T.P "ILI", nga fshati Banjë për lirimin nga pagesa e kështit të katërt të shfrytëzimit të Pishinës Publikë në fshatin Banjë

Halil Morina: Është çështje komplekse spo me intereson kush është, por edhe s'kanë punuar e tash qysh me ju kërkuar taksë.

Alban Krasniqi: Mbas spo ka prokuror e drejtësi folni qysh doni tash, se për asetin publik kur e merr në shfrytëzim ai thotë është i imi e tani anën tjetër ja bëjmë zero shfrytëzimin, por ka biznese që fitimin zero e ka pas e qiranë e ka pas obligim. Trajtimi duhet me kanë i barabartë, nëse qeveria i ka lejuar disa me punuar nuk mendoj meja falë, unë mendoj se duhet t'i ndërpritet kontrata sepse kur ai ka pas fitim ska ardhe kurr tek ne.

Hashim Vrenezi: Kontratën për shfrytëzim e ka pas për 2019 – 2020 në 2019 ai ka paguar, por kërkoj me dite a ka pranuar ndonjë ndihmë prej pakos për rimëkëmbjen ekonomike nga Qeveria e Republikës së Kosovës që ju ka ofruar keti biznesi, për me mujt qatë pjesë te ndihmës meja zbritet knej.

Valon Krasniqi: Ata e di që janë me Nismën dhe çdo veprim po bëhet politik, por që pandemia i ka demtu gjitha bizneset ndoshta jo njëjtë të gjithë e që pishinat i ka dëmtuar shumë. Pra jam që këtë kërkesë ta shqyrtojmë në Kuvend.

Alban Krasniqi: Nuk është e njëjtë se me këtë kërkesë në direkt po ndërhyjmë në konkurrencën e lirë që Pdk po thotë nuk bën me ndërhy. Dhjetëra biznese në këtë kohë janë shuar e që ky edhe herën e parë kur ja kemi falë borxhin nuk na ka sjellë gjendjen që ja kemi kërkuar, pra kjo kërkesë është e pa ligjshme me trajtuar.

Rrahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë për kuvend këtë kërkesë?

Për ishin 5, kundër 1.

Shqyrtimi i raportit të Drejtorisë për Urbanizëm për realizimin e projekteve kapitale për vitin 2020.

Alban Krasniqi: Ne për mbledhje duhet të kemi informacione;

Lisën e projekteve kapitale të pa realizuara, projekteve në realizim dhe ato në realizim e sipër për vitin 2020.

Arsyeshmëria e devijimit të projekteve.

Raport të veçantë, raportin e tenderimit dhe dosjen lidhur me ndërtimin e shkollës në fshatin Gurebardh.

Informacion lidhur me vendosjen e nxemjes në sallën e sportit në fshatin Astrazup.

Halil Morina: Nga shkurti-marsi jepen raportet nëse ka diçka specifike në rregull që kërkohet raport veç më kërkuar raport kur ende punët në teren s'kanë përfunduar smuj mu pajtu kështu.

Rrahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë për kuvend këtë pike?

5. Zbatimi i Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoha komunale për vitin 2020.

Hashim Vrenezi: Disa biznese me këtë rregullore janë ngarkuar me taksa si Uester union e janë ngarkuar me nga 700 euro, pastaj Vllesa. Kërkoj pra me rishqyrtu këtë rregullore dhe ato ngarkesa të pa drejt.

Muharrem Morina: Tash më nuk ka mundësi me ri shqyrtua rregulloren, sepse edhe jemi vone dhe nëse kthemi mbrapa janë procedurat që disa muaj na humbin kohë, tash ato biznese nëse janë ngarkuar me taksa ato e kanë pas mundësinë e ankesës.

Hashim Vrenezi: Kërkojë të kemi Raport lidhur me ngarkesën me taksa të Institucioneve të pagesave dhe transfereve në Malishevë gjatë kohës së pandemisë, kur dihet se kuvendi i ka liru në bazë të Rregullores për Ngarkesa, Tarifa dhe Gjoha Komunale për vitin 2020.

Shqyrtimi i kërkesës nr.06/144 datë: 12.11.2020 për ndërrimin e destinimit të tokës parashtruar nga Taib Gashi nga fshati Kijevë.

Alban Krasniqi: Shkresat e drejtorive për kuvend duhet veç drejtori mi berë jo edhe kujt t'i teket Rrahim Morina: Kush jeni te rekomandohet kjo kërkesë për kuvend? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/449 datë: 25.11.2020 e parashtruar nga Milazim Elshani nga fshati Ngucat, për dhënien e Pëlqimit për vazhdim të kontratës .

Muharrem Morina: Ky qytetarë me këtë kërkesë nuk e pengon asgjë askënd, sepse ky nëse ka kërkuar me ba një pyllëzim me diçka çka e pengon Komunën.

Hashim Vrenezi: Nëse na lejohet meja dhanë pëlqimin të mendojmë a na dëmton diçka neve.

Alban Krasniqi: Jam të kemi informacion prej drejtorive e kuvendi është organi i fundit që merret, po ashtu me vendim ne kemi pas vendosur që lidhur me këto te këtë dëgjim publik, shpallje. E bien kryetari ose drejtorja na rekomandojnë dhe ne pastaj e vlerësojmë, pra me këtë kërkesë duhet mu marrë drejtorja e Bujqësisë dhe e Urbanizmit.

Rrahim Morina: Kush jeni që të kërkohet prej Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillimi Rural dhe Drejtorisë për Urbanizëm kërkohet që të bëjnë trajtimin e mëtutjeshëm për zhvillimin e procedurave të kërkesës në fjalë?

Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/451 datë: 26.11.2020 e parashtruar nga Hamdi Kastrati nga fshati Zatriq Komuna e Rahovecit, për dhënien e Pëlqimit për vazhdimin e punimeve në gurëthyes.

Rrahim Morina: Kush jeni që të kërkohet prej Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillimi Rural dhe Drejtorisë për Urbanizëm kërkohet që të bëjnë trajtimin e mëtutjeshëm për zhvillimin e procedurave të kërkesës në fjalë?

Unanimisht ishin për

Kërkesa nr.02/502 datë: 07.12.2020 e parashtruar nga banoret e lagjes Samadraxha nga fshati banjë për ndarjen e një lokacionit për shfrytëzim të përbashkët për nevoja të ndryshme të pritjes.

Rrahim Morina: Ne ju kthejmë një përgjigje që këta ta kompletojnë kërkesën me dokumente shtesë, pasi që ne shkresat e lëndës-kërkesës ka dokumente si Fleta poseduese, kopja e planit dhe tjera që mungojnë.

Kërkesa nr. 02/507 datë: 09.12.2020 e parashtruar nga Fazli Mazreku, Mevludin Mazreku dhe Hajrë Mazreku nga Malisheva, për anulimin e vendimit dhe ndërprerjen e punimeve në varreza.

Alban Krasniqi: Kjo nuk na përket neve hiq, këtu duhet drejtorja e Urbanizmit, Inspektoratit mu marre e jo ne me marrë ndonjë vendim politik, prona është publike dhe nëse s'kemi bazë ligjore me marrë ndonjë vendim.

Hashim Vrenezi: Unë po mendoj se pa dëgjim publik kanë marrë vendim me ba aty pronë për varreza. Ne duhet meju ofrmu ndonjë zgjidhje që palët mos me pas ndonjë problem, se ne takim më njërin aty ata thonë se të paret e tyre kanë vendos me varreza poshtë një pjesë e jo krejt.

Alban Krasniqi: Arsyeja legjitime është se ajo zonë aty ka me kanë rruga e zgjeruar me 4 korsi dhe ai vend është në hyrje të qytetit.

Hashim Vrenezi: Unë jam me rekomanduar për kuvend dhe institucionet lokale me ba një takim me ata qytetarë dhe me ju ba një zgjidhje.

Rrahim Morina: Në atë vend janë varrezat aty a bërë një përkufizim dhe palët pretendojnë, ne lidhur me kërkesën ne fjalë pasi i ofrojmë një përgjigje që ky Organ nuk është kompetent për të vendosur, pasi që ky rast është në kontest gjyqësor i iniciuar nga palët në Gjykatë. Kush jeni te ju japim këtë përgjigje? Për ishin 2, kundër 3, 2 abstenime.

Kërkesa nr. 02/497 të datës: 07.12.2020 e parashtruar nga Shkolla e Futbollit Talenti dhe Top Besa në Malishevë, për mbështetje financiare.

Alban Krasniqi: Këta kanë përfituar një herë, dehet me pas thirrje publike si OJQ.

Rrahim Morina: Nuk kemi mundësi me marrë ndonjë vendim për mbështetje në mungesë të mjeteve financiare. I kthejmë një përgjigje.

Kërkesës 02/505 datë: 08.12.2020 të parashtruar nga Nebih Zogaj nga fshati Lladroc, për ndihmë financiare për renovimin e shtëpisë së djegur nga zjarri.

Rrahim Morina: Kush jeni të rekomandohet kjo kërkesë për Kuvend? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.12/227 datë:10.12.2020 të parashtruar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, për miratimin e Planit të Veprimit Rinor Lokal 2021-2023.

Mehdi Krasniqi: Kemi sjellë në KpF Planin e Veprimit lokal 2021-2023 dokument strategjik i hartuar nga gjitha Ojq-të. Që këtij i ka paraprirë një pyetësor në 3 shkolla të mesme me marrë mostrat bashkë me plane tjera të rinisë.

Hashim Vrenezi: A ka pas plan të tillë në vitet paraprake, me pa fondin sa ka qenë qysh a shpërnda pra 3 vitet e kaluara.

Mehdi Krasniqi: Ne kemi pas planin por sa realizuar.

Alban Krasniqi: Prej miratimit të Ligjit për rini Kuvendi i ka aprovu me kosto, por Drejtoria për Kulturë e ka buxhetin e vet dhe ne s'kemi nevojë me ju nda buxhet e ne duhet mu siguruar që aj buxhet me shku për rini. Është e çuditshme kur ceket zgjidhja e misterit dhe mbajtja e kurseve me një vlerë kaq të madhe.

Valon Krasniqi: Ne duhet kur e hartojmë buxhetin mos t'i largojmë rininë dhe idetë e tyre.

Rrahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë për Kuvend? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/455 datë: 30.11.2020 e parashtruar nga zj.Bukurije Hasanaj-Bashota nga fshati Bubavec, Komuna e Malishevës, për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor, për trajtim shëndetësor të vajzës së sajë znj.Vlera Bashota

Rrahim Morina: Kush jeni te ja ndajmë 500 € (pesëqind euro) Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/508 datë: 09.12.2020 e parashtruar nga z. Elmi Buçaj nga Fshati Lladroc, Komuna e Malishevës, për mbështetje financiare për hapjen e pusin për furnizim me ujë.

Rrahim Morina: Kush jeni te ja ndajmë 500 € (pesëqind euro) Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr. 02/513 të datës: 14.12.2020 e parashtruar nga Klubi i Volejbollit Malisheva Besa në Malishevë, për mbështetje financiare të KvF "Malisheva".

Rrahim Morina: Nuk kemi mundësi me marrë ndonjë vendim për mbështetje në mungesë të mjeteve financiare. I kthejmë një përgjigje.

Kërkesa 02/515 datë:14.12.2020 të parashtruar nga Muharrem Morina nga fshati Astrazup, për ndihmë financiare për meremetim të shtëpisë.

Rrahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë për Kuvend? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/510 të datës:09.12.2020 e parashtruar nga Operatoret e Transportit Urban dhe Ndërrurban të Komunës së Malishevës.

Rrahim Morina: Parashtruesve të kërkesës ju ofrojmë përgjigje qe Komuna e Malishevës deri me tani nuk ka subvencionuar asnjë biznes, pasi që nuk ka mjete financiare për këtë qëllim. Nëse ndonjëherë do të subvencionojë kompanitë e dëmtuara gjatë pandemisë COVID-19 duke u bazuar në kriteret, do të ketë parasysh edhe kërkesën tuaj.

Rrahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve

Ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 17:00

Procesmbajtësi

Naim Avdiqaj jur. i dip

